



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 283, Datë 07.11.2022

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALB ENERGY TRADE” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 07.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1885 prot, datë 4.11.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike” dhe qëndrimin e Këshilltares së bordit,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 266, datë 14.10.2022, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, pasi dokumentacioni i depozituar nga shoqëria nuk ishte sipas ndryshimeve të rregullores të miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 220/2022, si dhe nuk ishte realizuar pagesa e aplikimit për t’u licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Pas marrjes së këtij vendimi, me shkresën e protokolluar me nr. 1770/2 prot., datë 17.10.2022, shoqëria ka bërë me dije se ka kryer dhe diferencën e pagesës që përkon me pagesat e reja të aplikimit.
- ERE me shkresën nr. 1770/3 prot., datë 25.10.2022, ka orientuar shoqërinë se nëse brenda 1 (një) muaji nga marrja dijani e këtij vendimi për mos fillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin sipas kërkesave të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë

elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, dokumentacioni i paraqitur në aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

- Brenda afatit 1-mujor, sikurse përcaktuar në nenin 10, pika 7, të rregullores, shoqëria me shpresën e protokolluar në ERE me nr. 1770/4 prot., datë 28.10.2022, ka paraqitur dokumentacion për licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); Shtojcën 1 dhe Shtojcën 1E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (Aneksi A).
- Aplikuesi ka kryer për llogari të ERE-s pagesën sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores.
- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Alb Energy Trade” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c” si dhe pikë 2.5 të rregullores. Nga ky aplikim rezulton se shoqëria duhet të plotësojë:

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ;

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshminë e penaltetit) për vetë shoqërinë “Alb Energy Trade” sh.p.k. dhe për administratorin e saj.
- **gërma “c”**: Aplikuesi duhet të bëjë me dije nëse është bërë miratimi i strukturës organizative të saj dhe në kuptim të kërkesave specifike të këtij neni, shoqërisë do t’i kërkohet informacion mbi stafin teknik që do të angazhohet me veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në strukturën organizative përfundimtare të saj.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI